

URDHËR
Nr. 98, datë 9.7.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ndarjes V, të nënndarjes “i”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, z. Kastriot Gurra, për të autorizuar dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me largësi mbi 100 km.

2. Në bazë të pikës 1 të këtij urdhri, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, në çdo autorizim përcakton kohën e zgjatjes së shërbimit, qëllimin e tij dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e ASHSH-së për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku